



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 19, dt. 30. 01. 2015

Në mbështetje të nenit 29, pika 4, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 30.01.2015, pasi shqyrtoi propozimin për shpalljen e Ansambllit Monument Kulture të qytetit të Bilishtit dhe miratimin e rregullores për administrimin e tij, të diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit për “Shpalljen e Ansambllit Monument Kulture të qytetit të Bilishtit dhe miratimin e rregullores për administrimin e tij”.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI